



Ministria e Arsimit dhe Shkences

# TIK-Shkolla në Shqipëri

(Shkolla me Teknologji Informacioni e Komunikimi)

---

Nismë e Kryeministrit të Shqipërise

Një program nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës për paisjen e shkollave me Kompjutera dhe lidhjen e tyre me Internet.

# Në këtë Prezantim:

---

- Plani i Programit
- Shkollat, mësuesit dhe nxënësit
- Objektivat Arsimore
- Krijimi i TIK-Shkollave
- Zhvillimi i qëndrueshëm
- Zbatimi dhe fazat

# Master Plani

---

Master Plani u hartua nga një grup pune gjatë muajit Dhjetor 2005. Ky Plan identifikon:

- Rëndësine që ka një edukimi bashkëkohor në rritjen e aftësive për qytetarët Shqiptarë.
- Roli që globalizimi po luan në jetën tonë.
- Rëndësinë e nivelit arsimor në përputhje me standartet Europiane dhe Ndërkombëtare.

# Master Plani

---

Më shumë:

- Objektivi është krijimi i një ambjenti në të cilin nxënësit, si në zonat rurale dhe ato urbane të mund të mësojnë përdorimin e Teknologjive të Informacionit dhe Komunikimit.
- Përveç mësimit të Teknologjive të Informacionit dhe Komunikimit, ne do të krijojmë një rrjet shkollash për të mbështetur mundësitë e edukimit në distancë, përfshirë këtu aksesin në kurset online.
- Ne tashmë jemi në fazë implementimi të Teknologjive të Informacionit dhe Komunikimit në 110 shkolla;

# Disa shifra: Shkolla në vend

---




**1,749**  
Shkolla 9 vjeçare

A large red circle containing the number 1,749 and the text 'Shkolla 9 vjeçare'.

# Nxënës:

---



# Mësues

---



# Objektivat Arsimore

---

- Trajnim i mësuesve dhe trajnerëve në bazat e Teknologjive të Informacionit dhe Komunikimit, përdorimit të kompjuterit dhe aplikacioneve të tij, bazat e punës në Internet dhe njohuri bazë për mirëmbajtjen.
- Njohja me metodologjitë e mësimdhënies nëpërmjet Teknologjive të Informacionit dhe Komunikimit, gjë që i mundëson mësuesve dhe nxënësve të përmirësojnë procesin mësimor në të gjitha lëndët.
- Përvetësimi në një nivel të mjaftueshëm të Teknologjive të Informacionit dhe Komunikimit, që të lejojë nxënësit të kualifikohen për Licensën e përdorimit të kompjuterit deri në fund të shkollës së mesme.

# Licensa Europiane e Përdorimit të Kompjuterit

---

- Licensa Europiane e përdorimit të kompjuterit është një certifikatë ndërkombëtare për aftësitë në përdorimin e kompjuterit e përhapur në rreth 60 vende të ndryshme.
- Qëllimi kryesor i Licencës Europiane të përdorimit të kompjuterit dhe programeve të tjera të ngjashme, është rritja e njohurive bazë për Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit dhe atësive për përdorim të kompjuterit mbi baza globale dhe sigurimi i një certifikate të njohur në nivel ndërkombëtar.

# Krijimi i TIK-Shkollave (Shkolla me Teknologji Informacioni e Komunikimi)






---

Nërmjet partneriteteve MASH do të krijojë dhe përmirësojë vazhdimisht një model bazë për paisjet kompjuterike në shkolla. Ky model mund të përfshijë:

- 15 Kompjuterë për shkollat me një numër të madh nxënësish. Këta kompjuterë do të jenë të organizuar në një laborator, të lidhur në rrjet me njëri tjetrin dhe në Internet
- 7 Kompjuterë për shkollat me një numër më të ulët nxënësish.
- Standarti i paisjeve do të jetë i përshtatshëm për përdorimin në shkolla dhe me një nivel të ulët konsumimi të energjisë.



## Trajnimi i mësuesve dhe trajnerëve të tyre



## Trajnimi dhe çertifikimi i nxënësve



## Rrjetat



## Interneti



12/19/05

Programi TIK-Shkolla  
**Laboratorët**

# Rrjetat dhe Lidhja me Internet

---

- Duke patur parasysh që shërbimi i Internetit është i shtrenjtë, sigurimi i tij do të bëhet nëpërmjet një kontrate shërbimi nga një ose më shumë ofrues shërbimi interneti.
- Lidhja me Internet do të sigurohet ose nëpërmjet linjave fikse ose nëpërmjet lidhjeve Wireless. Në zonat rurale dial-up ose lidhja satelitore do të merret gjithashtu në shqyrtim.

# Energjia

---

- Për shkak të situatës energjitike në vend, do të tregohet kujdes edhe në sigurimin e sistemeve të pandërprera të energjisë si: UPS, Bateritë dhe Inverterat.

Gjithashtu sigurimi i gjeneratorëve do të konsiderohet si zgjidhje nëse do të jetë e nevojshme.

# Aplikacionet

---

- Çdo rrjet shkolle do të pajiset me Aplikacione të paketës Office, aplikacione për vizatim, për Internetin si dhe për postën elektronike (e-mail).
- Aplikacione për administrim, që përfshijnë: mungesat e nxënësve, programin e mësuesve, regjistrin e notave, amzën shkollore, raportet dhe administrimin e përgjithshëm të shkollës, do të instalohen duke bërë kështu të mundur krijimin e një sistemi për shkollat. Kjo do të na lejojë gjithashtu ne, që të kemi të dhëna më të mira për sistemin tonë shkollor.

# Zhvillimi i qëndrueshëm: programi Adopto një Shkollë

---

Ne kemi nevojë për mbështetjen tuaj bujare

- Paketat e adoptimit janë bazuar në tipin e shkollës. Paketa do të përfshijë paisje kompjuterike, lidhje me Internet, mirmbajtje për tre vjet, trajnim, libra, mbështetje për sitemin elektrik, etj.
- Për laboratorët me 15 kompjutera kostoja e përafërt është llogaritur afro: 15,000 USD
- Për laboratorët me 7 kompjutera afro: 8,000 USD
- Adoptimi mund të jetë edhe për pjesë të paketës.

# Zhvillimi i qëndrueshëm : gjenerimi i të ardhurave

---

- Kostot operacionale janë detyrimet financiare afatgjata.
- Ato duhet të përballohen në një mënyre sa më të qëndrueshme.
- Hapja e laboratorëve të shkollave për publikun pas orëve të mësimit dhe gjatë fundjavës ofron mundësitë për të gjeneruar të ardhura të mjaftueshme për kostot operacionale të laboratorëve.

# Gjenerimi i të ardhurave

---

Qoftë direkt nga drejtuesit e shkollës ose nëpërmjet kontraktimit të kompanive private ose individëve, të krijohet mundësia që këto laboratorë të jenë të hapur për publikun, por sipas disa kushteve që do përfshijnë:

- Orarin e funksionimit, pagesën maksimale, Përmbajtjen dhe aplikacionet e lejuara;
- Mirëmbajtjen e Sistemit;
- Pagesën e kostove operacionale të lidhura me sa përmendem më lart si dhe pagesën e lidhjes me Internet;
- Pagesën në rast përdorimi për qëllime komerciale;
- Trajnimet dhe të ardhurat nga kurset e ofruara për publikun.

# Zbatimi

---

- Programi i TIK-Shkollave do të ketë një shtrirje kohore nga viti 2006-2008. Plani do të rishikohet periodikisht;
- MASH do të jetë struktura qeveritare përgjegjëse për implementimin e këtij plani;
- Një faqet e internetit [www.undp.org.al](http://www.undp.org.al) [www.km.gov.al](http://www.km.gov.al) ; [www.mash.gov.al](http://www.mash.gov.al) do të ketë gjithmonë informacion për publikun .
- UNDP do të sigurojë asistencën teknike dhe burimet njerëzore të nevojshme për implementimin e planit. UNDP do të sigurojë gjithashtu mbështetje logjistike nëse do të jetë e nevojshme.

# Fazat:

---

- **2006 - 65-75%** e nxënësve të shkollave të mesme dhe **5-10%** e nxënësve të shkollave fillore.
- **2007 – 90%** e nxënësve të shkollave të mesme dhe **40-50%** e nxënësve të shkollave fillore.
- **2008 – Pjesa e mbetur e nxënësve;**

# Struktura Implementuese: Task Force dhe Njësia e Zbatimit të Programit

---

## Task Forca :

- Do të sigurojë mbështetje kombëtare duke përfshirë të gjithë aktorët kryesore dhe pjesët e tjera të interesuara për të kontribuar në program;
- Do të iniciojë partneritete;
- Do të drejtojë veprimtari për gjetje fondesh;
- Do të sigurojë transparencë dhe objektivitet;
- Do të këshillojë në implementimin dhe strategjinë e programit.
- Njësia e Zbatimit të Projektit do të jetë pranë MASH e PNUD

# Konkluzioni:

---

- Ne kemi nevojë për mbështetjen tuaj për ta bërë këtë vision realitet për të gjithë nxënësit e Shqipërisë
- Nëpërmjet këtij programi shumë më tepër individë do të bëhen pjesë e një shoqërie produktive nga e cila do të përfitojmë të gjithë.



# Ju Faleminderit!